AKT NORMATIV
Nr.2, datë 29.4.2011

PËR ZHVILLIMIN DHE PJESËMARRJEN E FORCAVE USHTARAKE TË BRITANISË SË MADHE NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT DETARE-AMFIBE "ALBANIAN LION, 2011"

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, të shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare-amfibe "Albanian Lion, 2011" në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.

Neni 2

Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 3500 trupave ushtarake të Britanisë së Madhe.

Neni 3

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është realizimi i operacioneve joluftarake të evakuimit (NEO-Non-Combatant Evacuation Operations) nëpërmjet detit dhe ajrit, duke përfshirë anije, helikopterë dhe mjete transporti.

Neni 4

Stërvitja zhvillohet në periudhën 27 maj - 3 qershor 2011, në rajonin e gjirit të Vlorës, në gadishullin e Karaburunit, ishullin e Sazanit, bazën e Porto-Palermos, bazën e Kuçovës.

Neni 5

Në këtë stërvitje angazhohen 3500 trupa, 10 anije luftarake, 1 nëndetëse bërthamore, 25 helikopterë sulmues dhe transporti dhe 100 mjete transporti të Forcave të Armatosura Mbretërore Britanike, të cilat do të kryejnë lëvizje gjatë 24 orëve në rajonin e përcaktuar të stërvitjes, sipas nenit 4 të këtij akti normativ. Në rajonin e Karaburunit do të kryejnë veprimtari 400 marinsa të Forcave të Armatosura Mbretërore Britanike, të cilët do të stimulojnë stërvitjen nga deti në tokë.

Neni 6

Trupat britanike gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951 dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.10 101, datë 26.3.2009.

Neni 7

Gjatë hyrjes, lëvizjes e daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, trupat dhe mjetet ushtarake britanike do të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha